



Prishtinë: 27.10.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1447_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2233_09_21** të dt. 10.09.2021;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 27.09.2021;

në seancën e mbajtur më datë 27.10.2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e konsumatorit R.R nga Komuna e Therandës.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2233_09_21, i datës 10.09.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRrE me datë 10.09.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2233_09_21, me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit R.R nga Komuna e Therandës, lidhur me kontestimin e faturës së energjisë elektrike të muajit 12/2016.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori R.R, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së për këto shkaqe:

- Konsumatori pretendon se fatura e muajit 12/2016 është e fryrë tej mase, për shkak që një shpenzim të tillë, prej 610.33 EUR i njëjti nuk e ka bërë as për tri (3) vite të tëra;
- Nga KEDS/KESCO nuk i është kthyer përgjigje për afro 8 muaj dhe se përgjigja tjetër i është kthyer pas tri viteve, në kundërshtim me afatet ligjore;
- Konsumatori R.R kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të anulohet vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2233_09_21 i datës 10.09.2021.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.10.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se fatura është e fryrë dhe se një shpenzim të tillë nuk do të mund ta bënte as për tri vite, Bordi i ZRrE-së thekson, se pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, e në veçanti, duke u bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike, transaksionet e konsumatorit dhe listat e leximit, është vërtetuar se, konsumatori për periudhën 12/2016 është



faturuar me kilovatë të grumbulluar, si pasojë e mos faturimit të shpenzimeve reale mujore në periudhat 10/11/2016, për shkak të mos qasjes nga lexuesit i KEDS-it në pikën matëse për periudhat e cekura si më lart. Kësisoj, Bordi konstaton se, konsumatori ka vepruar në kundërshtim me nenin 25 par. 1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku përcaktohet se: *“Konsumatori është i obliguar që të iu lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, me qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajiseve përkatëse, ashtu siç paraqitet në nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji”*. Andaj, me vet faktin që konsumatori nuk u kishte lejuar qasje punëtorëve të autorizuar të furnizuesit KESCO që të kenë qasje në pikën matëse, të njëjtit e kanë faturuar konsumatorin me kilovatë të grumbulluar.

Po ashtu, Bordi i ZRrE-së ka analizuar edhe Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik të dt. 13.01.2017 dhe Protokollin e Shqyrtimit të njehsorit elektrik të dt. 27.02.2017, me cka vërtetohet se me kërkesë të konsumatorit punëtorët e autorizuar të KEDS-it e kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe e kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 6409600 dhe e kanë vendosur për matje njehsorin e ri nr. 67265679, e po ashtu, se nga Qendra e Kalibrimit është konstatuar se: *“Njehsori elektrik është në rregull, njehsori elektrik bllobat (vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori elektrik dëmtime nuk ka, kurse gabimi në matje është +0.53%”*. Bazuar në të dhënat e evidentuara, Bordi thekson se gabimi i lejuar në matje prej +.53% është brenda kufirit të lejuar të gabimit e i cili është +-2.5%.

Me date 06.01.2017 Departamenti i faturimit në KESCO përmes korigjimit nr. 49871DPZ-142028, ka bere korigjimin e faturës se periudhës 12/2016 në vlerë **-43.01€**, duke bere shpërndarjen e kWh te faturuar për periudhën 10/2016 deri ne periudhën 12/2016 për shkak leximit dhe te faturimit jo te saktë. DMK ka analizuar korigjimin e bërë nga KESCO dhe konstaton se KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 3. *Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese.*

Duke u bazuar në nenin 5, par. 1.5 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, *“Të gjithë konsumatorët janë të obliguar që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*, Bordi thekson se konsumatori duhet të paguajë për shpenzimin e energjisë elektrike, sipas obligimeve ligjore të legjislacionit në fuqi.

Andaj, në harmoni me nenin 48 të Ligjit nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, Bordi i ZRrE-së i ka vlerësuar të gjitha pretendimet e ankuesit dhe i ka analizuar të gjitha dëshmitë dhe provat që lidhen më rastin në fjalë dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.10.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit R.R dhe
- Arkivit të ZRRE-së.